



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 188

**Tiranë – E mërkurë, 25 tetor 2017**

## PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Kuvendit nr. 104/2017, datë 25.10.2017	Për kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, “Për dhënien e autorizimit për arrestimin ose heqjen e lirisë, të kontrollit personal dhe të banesës të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, zotit Saimir Tahiri”.....	9243
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 114, datë 23.10.2017	Për delegim kompetence.....	9243
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 160, datë 12.10.2017	Mbi miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.....	9244
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 161, datë 12.10.2017	Për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.....	9258
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 162, datë 12.10.2017	Për fillimin e procedurës për miratimin e licencës për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.....	9258
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 163, datë 12.10.2017	Për fillimin e procedurës për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.....	9259
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 164, datë 12.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw....	9259
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 165, datë 12.10.2017	Mbi licencimin e shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 mw.....	9260
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 166, datë 12.10.2017	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	9261
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 4655/5, datë 12.10.2017	Kërkesë për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë dhe truall”, që preken nga “Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 kV, Laç 1 - Laç 2”.....	9261



**VENDIM**  
Nr. 104/2017

**PËR KËRKESËN E PROKURORISË  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS  
SË PARË PËR KRIME TË RËNDA,  
TIRANË, “PËR DHËNIEN E  
AUTORIZIMIT PËR ARRESTIMIN OSE  
HEQJEN E LIRISË, TË KONTROLLIT  
PERSONAL DHE TË BANESËS TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË  
SHQIPËRISË, ZOTIT SAIMIR TAHIRI”**

Në mbështetje të nenit 73, pikat 2 dhe 4, të Kushtetutës, të nenit 288 të Kodit të Procedurës Penale dhe të nenit 118, pikat 4 dhe 5, të Rregullores së Kuvendit, me rekomandim të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për:

- Dhënien e autorizimit për kontrollin personal dhe të banesës për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri.

- Dhënien e autorizimit për ndalimin e daljes jashtë shtetit, detyrimin për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, ndalimin dhe detyrimin për të qëndruar në një vend të caktuar, si masë shtrënguese të heqjes së lirisë në kuptim të shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të nenit 232, të Kodit të Procedurës Penale.

II. Rrëzimin e kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për dhënien e autorizimit për masën e arrestit në burg ose në shtëpi për deputetin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë Saimir Tahiri, në kuptim të shkronjave “d” dhe “dh”, të nenit 232, të Kodit të Procedurës Penale.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Gramoz Ruçi**

Miratuar në datën 25.10.2017

**URDHËR**  
Nr. 114, datë 23.10.2017

**PËR DELEGIM KOMPETENCE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është autoriteti të cilit i delegohet kompetenca e përfaqësimit të institucionit, në lidhje me proceset gjyqësore në të gjitha shkallët e gjyqimit dhe në Gjykatën Kushtetuese.

2. Autorizimet për përfaqësim ligjor, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në proceset gjyqësore ku thirret si palë në gjykim, lëshohen për aparatit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

3. Autorizimet për përfaqësim ligjor të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në proceset gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese, kur thirret si subjekt i interesuar, lëshohen nga Sekretari i Përgjithshëm, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë.

4. Përfaqësimi ligjor i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, sipas këtij urdhri, i jep të drejtë përfaqësuesit të autorizuar të kryejë çdo veprim procedural të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, gjatë seancës përkatëse të gjyqimit, me përjashtim të akteve procedurale, të tilla si, por pa u kufizuar: kërkesëpadi, ankime, rekurse, kërkesa për pezullim ekzekutim vendimi.

5. Ky urdhër nuk cenon vlefshmërinë e autorizimeve të lëshuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave, për proceset gjyqësore në të cilat ky institucion ka qenë palë dhe që kanë filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe struktura përgjegjëse për çështjet gjyqësore në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Arben Ahmetaj**

**VENDIM****Nr. 160, datë 12.10.2017****MBI MIRATIMIN E RREGULLORES PËR  
PROCEDURËN E REGJISTRIMIT NË  
TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; kapitullit III, pika III.1.2 të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 139, datë 25.8.2016, të bordit të ERE-s, të ndryshuar dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike, të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- Kjo rregullore hartohet në zbatim të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike, të miratuara me vendim të bordit të ERE-s nr.139, datë 25.8.2016., të ndryshuar, kapitulli III, pika III.1.2.

- Me shkresën nr. 6583 prot., datë 18.10.2016, OST sh.a. ka dërguar në ERE kërkesën për miratimin e rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.

- ERE, me vendimin nr. 4, datë 19.1.2017, filloi procedurën për miratimin e “Rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”.

- ERE, me shkresën nr. 91 prot., në datën 26.1.2017, dërgoi draftrregulloren për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike, për marrje mendimi, pranë subjekteve: OSHEE sh.a., KESH sh.a., MEI, Autoriteti i Konkurrencës, AAES, Shoqata e Prodhuesve të Vegjël të Energjisë Elektrike, FIAA, si dhe AREA.

- Autoriteti i Konkurrencës u shpreh se draftrregullorja për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike nuk bie në kundërshtim me ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.

- Në datën 2.5.2017, ERE në mbështetje të nenit 27 dhe 29 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të saj”, të miratuara me vendimin e bordit të ERE-s me nr. 96, datë 17.6.2016, organizoi një seancë dëgjimore mes

përfaqësuesve të ERE-s, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a., për të diskutuar propozimet e OSHEE sh.a.

- OST sh.a, me shkresën 2631/1 prot., datë 22.5.2017, ka përcjellë në ERE draftin e përmirësuar siç kanë rënë dakord mes palëve në seancën dëgjimore.

- Me shkresën nr. 91/6 prot., datë 22.6.2017, u është kërkuar palëve të interesit të shprehin opinionet dhe komentet mbi draftin e përmirësuar nga OST sh.a.

- Nuk rezultoi të ketë komente mbi draftin e përmirësuar e dakordësuar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë “Rregulloren për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**RREGULLORE**  
**PËR PROCEDURËN E REGJISTRIMIT NË**  
**TREGUN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

**KAPITULLI I**  
**TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Këto dispozita hartohen në zbatim të “Rregullave të përkohshme të tregut shqiptar të energjisë elektrike”, kapitulli III, pika III.1.2, të miratuara me vendimin nr. 139, datë 15.8.2016, të bordit të ERE-s, të ndryshuar.

Neni 2

Kjo rregullore përcakton procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike për çdo person, fizik apo juridik, vendës apo i huaj, të pajisur me licencë nga Enti Rregullator i Energjisë në përputhje me nenin 37, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i cili kërkon të



marrë pjesë në tregun e energjisë elektrike, të organizuar nga Operatori i Tregut të OST sh.a.

## KAPITULLI II APLIKIMI

### Neni 3

Aplikuesi që kërkon të regjistrohet për pjesëmarrje në tregun shqiptar të energjisë elektrike plotëson formularin A1 bashkëlidhur, të miratuar nga OST sh.a.

Ky formular tërhiqet pranë OST-OT-së ose në internet, në faqen elektronike të OST sh.a.

### Neni 4

Formulari dhe dokumentacioni bashkëngjitur dërgohen me postë pranë OST-OT-së, shoqëruar me një kërkesë zyrtare.

### Neni 5

Aplikuesi do t'i bashkëngjisë formularit A1 të regjistrimit dokumentet e mëposhtme:

- informacion teknik, të miratuar nga OST sh.a.;
- licencë, kopje e noterizuar;
- dokumente të lëshuara nga OST sh.a. dhe/ose OSSH, që jep akses në rrjet, atë të transmetimit dhe/ose shpërndarjes për rastet e tranzitimeve;
- një kopje të certifikuar të bilancit të fundit vjetor dhe të depozituar në organet e tatimitaksave;
- përkshkrim për mjetet e komunikimit, deklaratë origjinale e aplikuesit;
- informacion mbi detajet dhe mënyrën e komunikimit.

### Neni 6

Çdo aplikues/palë e licencuar që dëshiron të bëhet pjesëmarrës në tregun shqiptar të energjisë elektrike duhet të depozitojë në OST-OT garancinë financiare për të gjitha shërbimet që sigurohen nga OST sh.a., në përputhje me "Procedurat për llogaritjen e garancisë dhe kontrollin e depozitave", të përgatitura nga OST-OT-ja dhe të miratuara nga ERE.

### Neni 7

Brenda 10 ditëve punë nga marrja e dokumenteve të regjistrimit, OST-OT-ja do të verifikojë të dhënat e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur. Jo më vonë se 3 ditë punë pas përfundimit të këtij afati do t'i dërgojë njoftim aplikuesit për vendimin e marrë lidhur me

aplikimin për regjistrim në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me formularin A2 të miratuar nga OST sh.a.

## KAPITULLI III PRANIMI I APLIKIMIT

### Neni 8

Aplikuesit që ka marrë njoftimin për pranimin e aplikimit për regjistrim në tregun e energjisë elektrike ose që i janë rekomanduar udhëzime dhe kushte të detyrueshme për rregullimin e gabimeve të mundshme në formularët e aplikimit dhe dokumentet bashkëngjitur duhet të kthejë përgjigje për plotësimin e kërkesave të parashtruara në këtë formular, nga OST-OT-ja, brenda 10 ditëve punë nga dita që ka marrë njoftimin.

### Neni 9

Pas zbatimit e të gjitha kërkesave të mësipërme të regjistrimit, OST-OT-ja do të regjistrojë pjesëmarrësin në regjistrin e palëve dhe do të nënshkruajë marrëveshjen e pjesëmarrjes në treg, të miratuar nga ERE.

### Neni 10

Pas nënshkrimit të marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg nga përfaqësuesi i autorizuar i aplikuesit, regjistrimi si pjesëmarrës i ri i tregut bëhet efektiv në datën e zbatimit të saj.

### Neni 11

OST-OT-ja do të publikojë në faqen e saj të internetit një listë të palëve të regjistruara me informacion mbi emrin, numrin e identifikimit, datën e regjistrimit dhe statusin.

### Neni 12

Çdo palë është e detyruar t'i dërgojë informacion Operatorit të Tregut mbi ndryshimin e informacionit të dhënë në regjistrim, brenda 6 ditëve punë nga ndodhja e ndryshimit.

### Neni 13

OST-OT-ja do t'i regjistrojë zyrtarisht të gjithë pjesëmarrësit e tregut në tregun e energjisë elektrike duke i evidentuar në një regjistër të veçantë.



KAPITULLI IV  
REFUZIMI I APLIKIMIT DHE  
MOSMARRËVESHJA PËR REGJISTRIMIN

Neni 14

OST-OT-ja mund ta refuzojë regjistrimin në tregun e energjisë elektrike nëse konstaton këto raste:

a) gabime në formularin e regjistrimit dhe dokumentet bashkangjitur që nuk janë korrigjuar brenda 10 ditëve punë pavarësisht njoftimit për konstatimin e këtyre të metave;

b) detyrime ndaj operatorit të rrjetit të transmetimit të OST sh.a. që nuk janë likuiduar.

OST-OT-ja nuk do ta regjistrojë një palë në rast mosplotësimi të kushteve brenda termave të përcaktuar në këtë rregullore dhe në “Rregullat e tregut shqiptar të energjisë elektrike”.

Neni 15

Në rast refuzimi të regjistrimit, aplikuesi ka të drejtë ta kundërshtojë refuzimin me një ankesë drejtuar ERE-s brenda 10 ditëve pune pas marrjes së tij.

Neni 16

ERE do të verifikojë nëse arsyet e refuzimit janë të justifikuara dhe do ta marrë vendimin brenda 15 ditëve punë nga marrja e tij.

Neni 17

Në rast refuzimi të regjistrimit nga OST-OT-ja, aplikuesi mund të nisë një procedurë të re regjistrimi në tregun e energjisë elektrike, 1 muaj pas datës kur refuzimi i OST-OT-së merr formë të prerë.

Refuzimi i regjistrimit të dhënë nga OST-OT-ja merr formë të prerë të nesërmen e marrjes dijeni për vendimin e ERE-s që lë në fuqi këtë refuzim.

Në të kundërt, refuzimi i regjistrimit merr formë të prerë pas mbarimit të afatit të ankimit në ERE, prej 10 ditëve pune.

Neni 18

Në rast se vendimi i ERE-s konfirmon se Operatori i Tregut e ka refuzuar në mënyrë të pajustificuar regjistrimin në tregun e energjisë elektrike, OST-OT-ja është e detyruar që brenda 5 ditëve punë nga marrja e vendimit të ERE-s t'i dërgojë aplikuesit një njoftim për pranimin e formularit të regjistrimit në tregun e energjisë elektrike.

KAPITULLI V  
KËRKESA PËR TËRHEQJE, PEZULLIMI  
DHE PËRFUNDIMI I PJESËMARRJES  
NË TREG

Neni 19

Një pjesëmarrës tregu mund të tërhiqet nga tregu i energjisë elektrike me iniciativën e tij, bazuar në një njoftim me shkrim të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i këtij pjesëmarrësi, në përputhje me formularin A3 të miratuar nga OST sh.a. Njoftimi duhet paraqitur të paktën 3 muaj para datës së anulimit të regjistrimit të pjesëmarrësit të tregut. Pas marrjes së këtij njoftimi, OST-OT-ja do të informojë menjëherë të gjithë pjesëmarrësit e tjerë të tregut.

Neni 20

Nëse pjesëmarrësi nuk mund t'i plotësojë të gjitha kushtet e rregullave të tregut, atëherë pjesëmarrësi ose OST-OT-ja duhet të informojnë ERE-n brenda 10 ditëve pune.

Neni 21

1. OST-OT-ja do të pezullojë marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg të pjesëmarrësit, nëse plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

a) Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më një ose më shumë kushte të nevojshme për regjistrim si pjesëmarrës tregu (siç përcaktohet në këto dispozita).

b) Pjesëmarrësi i tregut nuk përmbush më kërkesat që lidhen me garancinë financiare ose nuk bën pagesat e tjera (të parashikuara në këto dispozita).

Neni 22

Nëse pjesëmarrësi i tregut nuk mund të provojë se e ka shmangur shkakun (shkaqet) që shkaktoi pezullimin e tij, gjatë periudhës së specifikuar në njoftimin për pezullim, atëherë OST-OT-ja do të procedojë me përfundimin e marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg.

Nëse ky vendim i OST-OT-së kundërshtohet nga pjesëmarrësi, atëherë pas paraqitjes së ankesës, ERE do të verifikojë nëse arsyet për pezullimin e veprimtarive tregtare janë të justifikuara dhe do të marrë vendimin brenda 15 ditëve pune nga marrja e ankesës.



## Neni 23

Nëse regjistrimi i pjesëmarrësit të tregut pezullohet, atëherë të gjitha ofertat e mbetura pezull (të reja) të pjesëmarrësit të tregut do të anulohen automatikisht për gjithë periudhën e pezullimit.

## Neni 24

OST-OT-ja ka të drejtë të përfundojë marrëveshjen për pjesëmarrje në treg të një pjesëmarrësi tregu, në secilin nga këto raste:

- nëse pjesëmarrësi i tregut nuk respekton marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg;
- nëse pjesëmarrësi në mënyrë të përsëritur shkel rregullat e tregut dhe kodeve në fuqi për tregun shqiptar të energjisë elektrike.

## Neni 25

OST-OT-ja shfuqizon menjëherë marrëveshjen për pjesëmarrjen në treg, kur ERE i heq pjesëmarrësit në treg licencën përkatëse. Të gjitha ofertat e tregut të këtij pjesëmarrësi anulohen automatikisht që nga data e deklaruar në njoftim.

## Neni 26

Pjesëmarrësi i tregut, marrëveshja për pjesëmarrjen në tregun e të cilit ka përfunduar, është përgjegjës për gjitha detyrimet ligjore që ka ndaj OST-OT-së.

## Neni 27

Këto dispozita hyjnë në fuqi pas miratimit nga ERE.

**X**

Logo e Aplikuesit

**FORMULARI A1****Aplikim  
për  
pjesëmarrje në tregun e energjisë elektrike**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

- Aplikuesi: \_\_\_\_\_

- Adresa: \_\_\_\_\_

- Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_

- Numri i identifikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, NUIS: \_\_\_\_\_

- Licensuar nga ERE, me vendim nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

- Me llogari në Bankën \_\_\_\_\_

Nr. llogarie \_\_\_\_\_, kod \_\_\_\_\_

- Energjia elektrike e përdorur/gjeneruar në një vit, para datës së aplikimit është \_\_\_\_\_ mwh.

- Bashkëlidhur edhe dokumentacioni vijues:

1. Licenca (për aktivitetin e licencuar - dokument kopje e noterizuar);
2. Informacion teknik (formular TIP i miratuar nga OST-ja – dokument origjinal);
3. Dokument të lëshuar nga OST-ja dhe/ose OSSH-ja që jep akses në rrjet (nëse disponohet, për rastet e tranziteve në rrjetin e transmetimit dhe/ose shpërndarjes – dokument kopje);
4. Bilanci vjetor, i depozituar në organet e tatim-taksave (për vitin e fundit kalendarik – dokument kopje e noterizuar);
5. Përshkrim për mjetet e komunikimit (formular TIP i miratuar nga OST-ja – dokument origjinal);
6. Informacion mbi detajet dhe mënyrën e komunikimit (formular TIP i miratuar nga OST-ja – dokument origjinal);
7. Garancia financiare e regjistrimit në treg (lëshuar nga Banka, mbështetur në formular TIP, i miratuar nga OST-ja – dokument origjinal).

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënskrimi dhe vula)*

**X**

Logo e OST

**FORMULARI A2**

Nr. \_\_\_\_\_ prot., datë \_\_\_\_\_

**Njoftim mbi aplikimin  
për  
pjesëmarrje në tregun e energjisë elektrike**

Drejtuar:

- Aplikuesit: \_\_\_\_\_
- Adresa: \_\_\_\_\_
- Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_,
- Numri i identifikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, NUIS: \_\_\_\_\_

Në përgjigje të aplikimit tuaj, nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, për regjistrim në tregun shqiptar të energjisë elektrike dhe në zbatim të “Rregullores për procedurën e regjistrimit në tregun e energjisë elektrike”, ju njoftojmë:

A. Aplikimi juaj për regjistrim pranohet, pasi është i plotë dhe i rregullt.

B. Aplikimi juaj refuzohet, pasi nuk është i plotë dhe/ose i rregullt:

- a. \_\_\_\_\_
- b. \_\_\_\_\_
- c. \_\_\_\_\_

Plotësimi dhe/ose korrektimi i aplikimit duhet bërë brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së këtij njoftimi.

*Operatori i tregut*





# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion

### Mbi detajet dhe mënyrën e komunikimit në tregun e energjisë elektrike

Të dhëna të subjektit të licencuar

Emri i subjektit të licencuar: \_\_\_\_\_ *Sipas specifikimit në licencë*  
 Adresa: \_\_\_\_\_ *Adresa e rezidencës kryesore të të licencuarit*  
 Numri i identifikimit në QKB: NUIS: \_\_\_\_\_  
 Tel: \_\_\_\_\_ Fax: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

Pas regjistrimit në tregun shqiptar të energjisë elektrike, për kryerjen e aktivitetit të licencuar:

- Autorizoj, për dërgimin dhe konfirmimin e dokumenteve që lidhen me punën operative në tregun e energjisë elektrike, personin/personat:

1. \_\_\_\_\_ Tel: \_\_\_\_\_ Fax: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_ Tel: \_\_\_\_\_ Fax: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_  
 3. \_\_\_\_\_

- Autorizoj, për nënshkrimin e kontratave dhe faturave, që lidhen me aktivitetin në tregun e energjisë elektrike, personin/ personat:

1. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
 2. \_\_\_\_\_ Tel. \_\_\_\_\_ Fax. \_\_\_\_\_ e-mail \_\_\_\_\_  
 3. \_\_\_\_\_

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënskrimi dhe vula)*



# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion teknik Furnizues

Të dhëna të subjektit të licencuar për furnizim të energjisë elektrike

Emërtimi	Specifikimi	Shënime
Emri i subjektit të licencuar		<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Rezidenca		<i>Adresa e rezidencës kryesore të të licencuarit</i>
Licenca	<i>Nr. ____ datë _____</i>	<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Afati i licencës		<i>Sipas përcaktimit në licencë</i>
Aktiviteti i licencuar		<i>Sipas përcaktimit në licencë</i>
Autoriteti licencues		<i>Emri, shteti rezident i autoritetit licencues</i>
Kodi EIC		
Të dhëna financiare	<i>Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar</i>	
Volumi i transaksioneve	<i>_____ mmb</i>	<i>Volumi në vitin e fundit kalendarik</i>

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënskërimi dhe vula)*



X

Logo e Subjektit Licencuar

### Informacion teknik Prodhuesit e energjisë elektrike

Të dhëna për subjektin e licencuar për prodhimin e energjisë elektrike

Emërtimi	Specifikimi	Shënime
Emri i centralit		<i>Sipas licencës ose sipas projektit</i>
Pronësia	<i>Publik ose privat ose koncesion</i>	
Kapaciteti total i centralit	_____ <i>mw</i>	
Numri i njësive gjeneruese	_____ <i>njësi</i>	
Kapaciteti i njësive gjeneruese	_____ <i>mw</i>	
Lënda e parë	<i>Qymyr ose gaz, ose ujë, ose PV etj.</i>	
Tipi i centralit	<i>Kogjenerim, run of river, rrezatim diellor etj.</i>	
Eficienca e prodhimit	<i>kg/kwh ose m<sup>3</sup>/kwh, ose m<sup>2</sup>/kw etj.</i>	<i>Në ritin e fundit kalendarik ose sipas projektit</i>
Prodhimi mesatar vjetor	<i>kwh/vit</i>	<i>Në ritin e fundit kalendarik ose sipas projektit</i>
Viti i vënies në shfrytëzim		<i>Viti i vënies në shfrytëzim i njësive së parë</i>
Pika e lidhjes	<i>OST ose OSHEE etj.</i>	<i>Emri i kompanisë që administron rrjetin</i>
Tensioni në pikën e lidhjes	<i>220 kV ose 110 kV, ose 35 kV etj</i>	<i>Tensioni i rrjetit në pikën e lidhjes</i>
Pika/pikat e matjes	<i>P.sh. ana 6 kV e Tr T1 etj.</i>	<i>Specifikime mbi pikën ose pikat e matjes</i>
Kodi i pikës/pikave të matjes		<i>Sipas sistemit të menaxhimit matjes të op. të rrjetit</i>

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

Administratori  
(nënshkrimi dhe vulë)

*Shënim. Ky formular plotësohet veçmas për çdo central të përfshirë në licencën e të licencuarit.*



## Informacion teknik

## Operim i sistemit të shpërndarjes

Të dhëna të subjektit të licencuar për shpërndarje të energjisë elektrike

Emërtimi	Specifikimi	Shënime
Emri i subjektit të licencuar		<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Rezidenca		<i>Adresa e rezidencës kryesore të të licencuarit</i>
Licenca	<i>Nr. ____, datë _____</i>	<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Afati i licencës		<i>Sipas përvaktimit në licencë</i>
Aktiviteti i licencuar		<i>Sipas përvaktimit në licencë</i>
Kodi EIC		
Të dhëna financiare	<i>Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar</i>	
Zona e operimit të shpërndarjes	<i>Kufijtë gjeografikë të zonës</i>	<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Pika/pikat e lidhjes me ST-në		<i>Linja/linjat dhe/ose zbara/zbarat lidhëse me OST-në</i>
Kodi i pikës/pikave të matjes me ST-në		<i>Sipas sistemit të menaxhimit të matjes të OST-së</i>
Pika/pikat e lidhjes me SSH-në		<i>Linja/linjat dhe/ose zbara/zbarat lidhëse me operatorin publik të shpërndarjes</i>
Kodi i pikës/pikave të matjes me SSH-në		<i>Sipas sistemit të menaxhimit të matjes të operatorit publik të shpërndarjes</i>
Të dhëna mbi zonën e shpërndarjes	<i>Prodhimi i zonës (mwb/vit), konsumi i zonës (mwb/ vit), nr. i konsumatorëve tariforë dhe nr. i konsumatorëve jotariforë</i>	<i>Sipas vlerësimeve të paraqitura nga i licencuari në aplikimin për licencë</i>

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënshkrimi dhe vula)*



# X

Logo e Subjektit Licencuar

## Informacion teknik Tregtuesi

Të dhëna të subjektit të licencuar

Emërtimi	Specifikimi	Shënime
Emri i subjektit të licencuar		<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Rezidenca		<i>Adresa e rezidencës kryesore të të licencuarit</i>
Licenca	<i>Nr.____, datë _____</i>	<i>Sipas specifikimit në licencë</i>
Afati i licencës		<i>Sipas përcaktimit në licencë</i>
Aktiviteti i licencuar		<i>Sipas përcaktimit në licencë</i>
Autoriteti i licencues		<i>Emri, shteti rezident i autoritetit licencues</i>
Kodi EIC		
Të dhëna financiare	<i>Banka, adresa, llogaria bankare, kodi bankar</i>	
Volumi i transaksioneve	<i>_____ mmb</i>	<i>Volumi në vitin e fundit kalendarik</i>

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënskrimi dhe vula)*



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Datë \_\_\_\_\_

Drejtuar z. \_\_\_\_\_

Administrator i OST sh.a.

**Lënda: Kërkesë për regjistrim në Operatorin e Tregut të Energjisë Elektrike****I nderuar z. \_\_\_\_\_ ,**

Në zbatim të “Rregullave të tregut”, miratuar nga ERE me nr. \_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ju drejtohem me kërkesën për regjistrim, për t’u bërë palë në tregun shqiptar të energjisë elektrike, në përputhje me procedurën përkatëse të miratuar nga ERE.

Bashkëlidhur do të gjeni të plotësuar aplikimin për regjistrim, si edhe dokumentacionin e nevojshëm shoqërues.

Për të ndjekur procedurën e regjistrimit në operatorin e tregut:

Autorizoj z. \_\_\_\_\_ ,

Adresa: \_\_\_\_\_ ,

Tel: \_\_\_\_\_ , fax: \_\_\_\_\_ , e-mail: \_\_\_\_\_

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori*  
*(nënskrimi dhe vula)*



## Përshkrim

## Mbi mjetet e komunikimit në tregun e energjisë elektrike

Emri i subjektit të licencuar: \_\_\_\_\_

*Sipas specifikimit në licencë*

Adresa: \_\_\_\_\_

*Adresa e rezidencës kryesore të të licencuarit*

Numri i identifikimit në QKB NUIS: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_ fax: \_\_\_\_\_ e-mail: \_\_\_\_\_

Për kryerjen e aktivitetit të licencuar në tregun shqiptar të energjisë elektrike, do të komunikohet me Operatorin e Tregut, në përputhje me procedurat përkatëse të komunikimit, përcaktuar në “Rregullat e tregut” dhe akteve të tjera që rregullojnë tregun shqiptar të energjisë elektrike, nëpërmjet:

- komunikimit elektronik, adresat e të cilave janë deklaruar në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”;
- *fax*-it, në numrin përkatës të deklaruar në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”;
- numrit të telefonit dhe personave përkatës të autorizuar, të cilat janë deklaruar në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”;
- shërbimit të postës, në adresën e deklaruar në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”.

Për çdo ndryshim të të dhënave të deklaruara për komunikimin, që lidhen me operimin në tregun e energjisë elektrike, Operatori i Tregut do të njoftohet nëpërmjet ndryshimit të deklarimeve në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”, në afatet e përcaktuara në “Rregullat e tregut”.

Operatori i Tregut do të njoftojë te personat e autorizuar në “Informacionin mbi detajet e komunikimit”, pas nënshkrimit të “Marrëveshjes për pjesëmarrjen në treg”, adresat dhe kodet e nevojshme të komunikimit për kryerjen e transaksioneve në treg.

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori**(nënshkrimi dhe vula)*

**X**

Logo e Aplikuesit

**FORMULARI A3****Kërkesë  
për tërheqje nga tregu i energjisë elektrike**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

- Aplikuesi: \_\_\_\_\_
- Adresa: \_\_\_\_\_
- Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_
- Numri i identifikimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, NUIS: \_\_\_\_\_
- Licencuar nga ERE me vendim nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

Në zbatim të “Rregullave të tregut”, miratuar nga ERE, me nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ju drejtohem me kërkesën për tërheqje nga tregu i energjisë elektrike, në përputhje me procedurën përkatëse të miratuar nga ERE.

Për të vepruar në emrin tim, për të ndjekur procedurën e çregjistrimit në Operatorin e Tregut:

Autorizoj z. \_\_\_\_\_

Adresa: \_\_\_\_\_

Tel: \_\_\_\_\_, fax: \_\_\_\_\_, e-mail: \_\_\_\_\_

Subjekti i licencuar: \_\_\_\_\_

*Administratori  
(nënshkrimi dhe vulë)*



**VENDIM****Nr. 161, datë 12.10.2017****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
HARTIMIN DHE MIRATIMIN E  
LICENCËS PËR AKTIVITETIN E  
SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të seksionit II, nenit 22 dhe 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike, konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përmirësuar apo modifikuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të licencuarit me ato të parashikuara në ligjin nr. 102/2015, “Për gazin natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**

**VENDIM****Nr. 162, datë 12.10.2017****PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIMIN E LICENCËS PËR  
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË  
GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të seksionit II, neni 22, 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s, konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën e furnizimit të gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

**VENDOSI:**

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës për aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit Ahmeti**



## VENDIM

Nr. 163, datë 12.10.2017

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
MIRATIMIN E LICENCËS PËR  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË GAZIT  
NATYROR**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të seksionit II, neni 22, 23 të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror, të përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s,

konstatoi:

- Në zbatim të parashikimeve të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, ERE ka kompetencën për të hartuar licencën e tregtimit të gazit natyror.

- ERE ka hartuar draftin bashkëlidhur duke përcaktuar kushtet, afatet apo të drejtat e detyrimit e të licencuarit mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e licencës për aktivitetin e tregtimit të gazit natyror.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI  
Petrit Ahmeti**

## VENDIM

Nr. 164, datë 12.10.2017

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË  
“EUROBIZNES” SHPK, NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET:  
“LUSEN 1”, ME FUQI TË INSTALUAR  
0.315 MW; “LUSEN 2”, ME FUQI TË  
INSTALUAR 0.6 MW; “LUSEN 3”, ME  
FUQI TË INSTALUAR 0.6 MW; DHE ME  
FUQI TOTALE TË INSTALUAR 1.515 MW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k., si dhe informacionin shtesë të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw,

konstatoi se:

- ERE me vendimin nr. 130, datë 16.8.2017, filloi procedurat për licencimin e shoqërisë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw.

- Në vendimin sipërcituar është konstatuar dhe lënë detyrë për aplikuesin që: Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me nenin 9, pika 4.1.3, germa “c”, shtrirja gjeografike e vendit ku do të ngrihet apo zhvillohet veprimtaria duke dhënë referencat ekzakte (numër parcele, numër regjistri kadastrë) dhe të paraqitura në hartë me shkallë 1:25000 dhe germa “d” - nenin 9, pika



4.1.5, germa “a”, miratimi i pikës së lidhjes dhe germa “b”, leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

- Shoqëria “Eurobiznes” sh.p.k. rezultoi se plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Eurobiznes” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et: “Lusen 1”, me fuqi të instaluar 0.315 mw; “Lusen 2”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; “Lusen 3”, me fuqi të instaluar 0.6 mw; dhe me fuqi totale të instaluar 1.515 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative, brenda 30 ditëve nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

#### VENDIM

Nr. 165, datë 12.10.2017

### MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “THE BLUE STAR” SHPK NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “GORICË”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.747 MW

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, germa “a”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “The Blue Star” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga HEC-i “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 mw,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “The Blue Star” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4 dhe 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s



## VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “The Blue Star” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Goricë”, me fuqi të instaluar 1.747 mw, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

## VENDIM

Nr. 166, datë 12.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR  
LICENCIMIN E SHOQËRISË “SMART  
TRADE & CONSULTING” SHPK NË  
AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “e”; 5, pika 1, germa “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19 të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k., të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formatit i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacioni tekniko-ekonomik (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar tërësisht.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

## VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Trade & Consulting” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI  
Petrit Ahmeti

## KËRKESË

Nr. 4655/5, datë 12.10.2017

**PËR SHPRONËSIM ME INTERES  
PUBLIK**

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim me interes publik të pasurive të paluajtshme të tipit “tokë bujqësore, arë dhe truall”, që preken nga “Ndërtimi i linjës së transmetimit 110 KV, LAÇ 1-LAÇ 2”.

Subjekti kërkues i këtij shpronësimi është: OST sh.a. Tiranë.

Me anën e këtij publikimi, kërkojmë të njoftojmë personat që preken nga ky shpronësim mbi sipërfaqen e pasurisë që shpronësohet, pasurisë që dëmtohet dhe masën e kompensimit përkatës të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit, për secilin pronar sipas listës emërore bashkëlidhur.



Brenda 15 ditëve nga data e fundit e publikimit, personat që kanë emrin në listën emërore bashkëlidhur këtij njoftimi, kanë të drejtën të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse pranë Komisionit të Posaçëm të Shpronësimit në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I  
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
Gentian Këri**

**LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 KV LAÇ 1 - LAÇ 2**  
Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: tokë, arë, truall

Nr.	Numri i shtyllës	Pronësia										
		Emri	Atësia	Mbiemri	Lloji i pasurisë	Nr. kadastral	Nr. i pasurisë	Sasia Sip. e pronës m <sup>2</sup>	Sipërfaqja e shpronësi mit m <sup>2</sup>	Çmimi i tokës lekë/m <sup>2</sup>	Vlera e shpronësimit në lekë	Shënime
<b>BASHKIA KURBIN</b>												
<b>FSHATI LAC</b>												
1	1	Uzina e bakrit Lac			Truall	2365	324	68970	76.98	294	22633	
2	2	Uzina e bakrit Lac			Truall	2365			65.93	294	19385	
<b>BASHKIA KURBIN</b>												
<b>SHULLAZE</b>												
3	4	Pretendues			Arë	3441	96		58.37	278	16227	Nuk ka kartelë të hapur
4	5	Pretendues			Arë	3441	96		15.16	278	4214	Nuk ka kartelë të hapur
<b>BASHKIA KURBIN</b>												
<b>FSHATI LAC</b>												
5	7	Lek	Preng	Pervizi	Arë	2365	80/18	4570	23.17	321	7438	
		Bashkëpronësi familja Marku			Arë	2365	80/19	3000				
6	9	Pretendues				2365	45/25		47.83	321	15353	Ndryshuar nr. pas në 45/60
7	10	Pretendues				2365	68/1		16.59	321	5325	Nuk ka kartelë të hapur
8	12	Mhill	Vlash	Noka	Arë	2365	59/9	6380	76.98	321	24712	
								$\Sigma =$	<b>381</b>	$\Sigma =$	<b>115287</b>	

Sipërfaqe totale shpronësimi 381 m<sup>2</sup>  
Vlera totale e shpronësimit 115287 lekë

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2017

Adresa: Rr "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel/fax +355 4 24 27 004 Tel +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë